

Raport Mujor për fondin Master Pension

Fondi i Pensionit Privat Master Pension synon optimizimin e kthimit nga investimi duke minimizuar riskun, me qëllimin për t’ju siguruar anëtarëve të Fondit të ardhura më të larta dhe të sigurta në moshën e pensionit.

Data e raportit: 31.08.2025

Informacion për Fondin

Shoqëria Administruese e Fondit:	Credins Invest
Data e lançimit të fondit:	01 Gusht 2025
Monedha e Fondit:	Lek

Fondi i adresohet investitorëve që kërkojnë një cilësi jete gjatë pensionit e cila nuk rezulton më e ulët sesa faza përpara daljes në pension.

Profil i rrezikut dhe përfitimit

Ecuria e normës së kthimit të Fondit varet nga lëvizja e normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të Republikës së Shqipërisë. Historikisht këto norma kanë treguar luhatshmëri të ulët.

Rrezik i ulët			Rrezik i lartë			
Përfitimet tipike më të ulëta			Përfitimet tipike më të larta			
1	2	3	4	5	6	7

Fondi Master Pension ka një profil rreziku në nivelin 2, e cila përfaqëson risk të ulët.

Të dhëna kryesore për Fondin

Vlera Neto e Aseteve	5,507,719.87
Çmimi i kuotës	1,001.4036
Numri i anëtarëve	3
Kthimi nga investimi (01.08.2025-31.08.2025)*	0.14%

* Tarifa e administrimit është zbritur përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.

Karakteristikat e rrezikut të asetëve në Fond

Depozitat Bankare

Depozita Bankare si klasë asetë përmban rrezikun e kredisë së bankës dhe rrezikun e riçimitit në momentin e maturimit të saj.

Rreziku i riçimitit nënkupton uljen e normës së interesit kur depozita rivendoset me të njëjtin maturitet.

Obligacionet dhe Bonot Qeveritare

Këto asetë janë të emetuara nga Qeveria, agjencitë apo ndërmarrje të sponsorizuara nga Qeveria. Megjithatë, qeveritë nuk garantojnë

pagesën e interesit apo principalit. Obligacionet apo Bonot qeveritare janë subjekt i rrezikut nga normat e interesit dhe kanë nota krediti (“rating”) të ndryshme. Bonot përmbajnë rrezik nga interesat më të lartë se obligacionet me të njëjtën kohë deri në maturim.

Në 21 mars 2025, Agjencia Ndërkombëtare “Standard & Poor’s” përmirësoi vlerësimin për Shqipërinë në kategorinë ‘BB’ me perspektivë “të qëndrueshme”, nga kategoria ‘BB-’ që ishte vlerësuar në mars 2024, e cila ishte përsëri përmirësim prej vlerësimit ‘B+’ që qëndronte prej shumë vitesh. Gjithashtu, Agjencia Ndërkombëtare e vlerësimit “Moody’s” ka rishikuar vlerësimin e saj në datën 18 Tetor 2024, duke vlerësuar me rritje perspektivën e Shqipërisë nga “B1 – me perspektivë pozitive” në “Ba3 – e qëndrueshme”. Të njëjtin vlerësim e ka konfirmuar në opinion e dhënë në datë 8 Prill 2025. Rritja e vlerësimit të kreditit për Shqipërinë, redukton rrezikun e kreditit të asetëve të Fondit, duke qenë se asetet e Fondit investohen në instrumentet financiare që emetohet nga shteti shqiptar.

Kostot dhe Tarifat

Tarifa e Administrimit të Fondit mbahet nga asetet e Fondit. Tarifat që i ngarkohen Fondit janë si më poshtë:

Pagesa e hyrjes	0%
Pagesa e daljes	0%
Komisioni vjetor i administrimit	Deri në 1.2% në vit e Vlerës Neto të Aktiveve
Tarifa të tjera të vazhdueshme	Sipas Prospektit, Seksioni 18
Komisioni i administrimit dhe të gjitha kostot e tjera të listuara në një vit kontabël nuk do të tejkalojnë në asnjë rast maksimumin prej 1.5% të vlerës neto të aktiveve të fondit.	
Penalitetet në rast tërheqje të parakohëshme	Sipas Prospektit, Seksioni 11

Shpërndarja e Instrumenteve si përqindje e Aseteve Totale

Shpërndarja e Instrumentave	ALL	%Aseteve
Obligacione të RSH	5,419,815.57	98.29%
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	94,129.46	1.71%

